



Plani i Investimeve Kapitale me pjesëmarrje- KAVAJË

Dokumenti i Planit të Investimeve Kapitale

Dokumenti i Planit të Investimeve Kapitale (PIK) përmban listën e projekteve të përzgjedhura nga komisioni qytetar për një periudhë 3-5 vjeçare. Ky dokument përmban:

- Përshkrim të shkurtër për çdo projekt;
- Koston e plotë të projektit dhe koston e financimit sipas viteve dhe për çdo fazë (projekt, tender, ndërtim etj);
- Paraqitjen urbanistike dhe foton e vendit ku do të zbatohet projekti;
- Fushën e zhvillimit;
- Burimet e financimit, etj

Fazat e Projektit

Faza I- Identifikimi dhe mobilizimi i aktorëve kryesorë

U arrit një konsensus "gjithëpërfshirës" nëpërmjet konsultimeve, mirëkuptim i qartë i Kryetarit dhe antarëve të këshillit të Bashkisë për rëndësinë e këtij dokumenti, duke përfshirë një gamë të gjerë të pjesëmarrësve lokalë. Aktorët kryesorë në proces ishin: pjesëtarë të komunitetit (banorë sipas tre zonave), antarë nga komuniteti i biznesit (ndërtues, arkitektë, inxhinierë), nga OJQ, të rinjtë, grupe aktive të grave në komunitet, dhoma e tregtisë, media lokale (tv6 dhe tv2), grupe këshilltarësh etj.

Faza II- Organizimi i takimeve me publikun

Tërheqja e mendimit qytetar për nevojat në fushën e investimeve kapitale u realizua në tre takime të hapura për 6 lagjet. Për shkak të nivelit të ulët të pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në aktivitetet e Bashkisë, u organizuan disa takime fokus grup me këto grupe interesi.

➤ Gjithsej në takimet e hapura publike morën pjesë 195 qytetarë, ku rreth 14 % e tyre ishin gra.

➤ U shpërndanë rreth 150 anketa për tërheqjen e mendimit qytetar dhe biznesit lidhur me përcaktimin e tre investimeve kapitale më të rëndësishme për ta.

Faza III- Organizimi i procesit të përpunimit të informacionit

Informacioni është mbledhur nëpërmjet takimeve të hapura publike ose anketimit ku u përfshinë rreth 330 qytetarë dhe grupe interesi ose 1 në 30 familje të Kavajës. Informacioni i



përpunuar përmban 543 propozime. Në bashkëpunim me stafin e Bashkisë u bë proritizimi i listës sipas fushave, ku rreth 51% e tyre janë projekte

Faza e IV- Prezantimi i listës përmbledhëse të investimeve të propozuara

Në këtë fazë është bashkërenduar informacioni i Bashkisë me propozimet e qytetarëve. Departamentet e Bashkisë trajnohen për mënyrën se si t'i paraqesin propozimet e përpunuara në formularët përkatës të përgatitura për këtë qëllim.

Faza e V - Proçesi i vlerësimit të projekteve

Komisioni, që vlerësoi kërkesat nga pikëpamja e sigurisë dhe shëndetit të qytetarëve dhe kritereve të tjera, përbehej nga 33 antarë (9 të zgjedhur nga lagjet), ku 18 % ishin femra. Ky komision përbëhej nga qytetarë të përzgjedhur nga komuniteti, stafi i bashkisë dhe grupe të interesit.

Faza VI- Ngritja e Bashkëpunimit dhe Krijimi i Konsensusit

Asistenca e URI-t në këtë fazë synon përgatitjen e listës përfundimtare me projekte të prioritetuara mbi bazën e kritereve të vendosura me konsensus dhe me një vizion strategjik të përbashkët. Komisioni mori pjesë në dy trajnime mbi metodat e vlerësimit dhe lista përfundimtare me 59 projekte.

Faza VII- Përgatitja e produktit, Planit të Investimeve Kapitale (PIK)

U analizua informacioni financiar për

identifikimin e nevojave dhe burimeve të mundshme që do të mbështesin PIK, projektet janë të kategorizuara sipas viteve me përshkrimin teknik dhe fizibilitetin financiar respektiv.

- Analiza financiare: IKU ka organizuar trajnim mbi planifikimin financiar 3-5 vjeçar dhe përcaktimin e tepricës operacionale. Projektet e investimeve kapitale mund të buxhetohen çdo vit në vleftën 105328 mije lek (nga burimet e veta) ose 204143 mije lek duke ju referuar dhe burimeve të tjera të kushtëzuara të mundshme.

Faza VIII- Miratimi i PIK në Këshillin e Bashkisë

Mbas prezantimit përfundimtar në publik dokumenti u miratua nga Këshilli i Bashkisë dhe u publikua.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ SOROS

KOHËZGJATIA:

Janar 2010 – Korrik 2010

PËRFITUESIT:

- ✓ Bashkia Kavaje

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj. nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë

Rreth IKU

Që Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj. nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë